

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

### I DETYRUAR

**VARIANTI A**

E shtunë, 2 qershor 2012

Ora 10.00

**Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi**

**Shkollat e mesme artistike (kurrikula e re)**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi në total ka **25 pyetje**, 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në tri pjesë.

Në të tri pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10
Pikët											
Kërkesa	11a	11b	11c	11d	12	13	14	15	16a	16b	17
Pikët											
Kërkesa	18	19	20	21	22a	22b	23a	23b	23c	24	25
Pikët											

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

## PJESA I

*Udhëtimet e Guliverit: Argëtim apo egërsi?*

Që kur botuan, “Udhëtimet e Guliverit”, në vitin 1726, romani është lexuar në tri mënyra të ndryshme: si një histori e vërtetë, si një tregim argëtues për fëmijë dhe si një satirë e ashpër, drejtuar shoqërisë njerëzore. Libri flet për një udhëtar i cili, teksa përballet me mbytjen e anijes dhe fatkeqësi të tjera, ndeshet me disa shoqëri të ndryshme njerëzore. Në pamje të parë duket si një histori aventurash. Megjithatë Xhonatan Suift e shkroi librin duke pasur për qëllim që ta “zemëronte lexuesin dhe jo ta argëtonte” (Helmswood 32).

Një lexues i ditëve të sotme i “Udhëtimeve të Guliverit” mund të pyesë veten se si këto histori dhe personazhe në ato kohë janë marrë si të vërteta. Megjithatë, kur libri u botua për herë të parë, emri i Suiftit nuk u vendos në kopertinë për shkak të përmbajtjes satirike të librit. Në origjinal shkruhej: “Udhëtime nëpër vende të largëta të botës, nga Lemuel Guliver” (Fairly 59). Ky shënim dhe rrëfimi në vetën e parë, bëri që shumë lexues të besonin se historitë e udhëtimeve ishin ngjarje të vërteta.

Duke e parë nga ana historike, është krejt e pranueshme që njerëzit të besonin ngjarje të tilla. Libri u botua në kohë eksplorimesh. Evropianët po njiheshin me pjesën tjetër të botës nga historitë e eksploruesve, të cilët kishin udhëtuar në vende të largëta dhe të habitshme si, Afrika, Azia dhe Amerika. Edhe rrëfimet më të vërteta për këto vende mbeteshin fantastike për evropianët, të cilët ishin mësuar vetëm me mënyrën e tyre të jetesës. Për këtë arsye nuk është shumë e habitshme që shumë njerëz i morën udhëtimet e Guliverit si të vërteta. “Kësaj ideje të gabuar iu shtua edhe dëshmia e një kapiteni, i cili deklaroi se e njihje personalisht Kapiten Guliverin” (Rialto 44). Lexues të tjerë mendonin se autori thjesht po “i hiperbolizonte gjërat” (46). Ata nuk e pëlqenin librin, për shkak të prirjes që kishte autori për të stërholluar të vërtetën, por gjithsesi besonin se ngjarjet në thelb ishin reale.

Më vonë, romani “Udhëtimet e Guliverit” u shndërrua në një nga historitë më të njohura për fëmijë të të gjitha kohërave. Gjatë shekujve, janë krijuar shumë versione të shkurtuara dhe të ilustruara të librit. Pjesë të historisë janë përshtatur edhe në filma. Përshtatja më e fundit ka qenë në një serial të shkurtër, ku Ted Denson luan rolin kryesor. Ngjarjet dhe shoqëritë e krijuara nga Suift në këtë përrallë me imagjinatë kaq krijuese, përshtaten lehtë në artin e kinemasë. Megjithatë mendohet se libri në origjinal, i pashkurtuar, nxjerr, përmes këtyre tregimeve magjepsëse, qëllimin satirik të autorit.

Shoqëria e parë që takon Lemuel Guliveri është ajo e Liliputëve, një racë njerëzish të vegjël. Pasi gjejnë anijen e tij të përplasur në brigjet e tyre, qenieve të vogla u duhet të bëjnë një rrugë të gjatë për të kapur rob “Njeriun Mal”. Me kalimin e kohës ai fiton besimin e tyre dhe lihet i lirë për aq kohë sa do t’u bindej të nëntë ligjeve, që kishin krijuar liliputët për sigurinë e tyre. Për shembull, në Ligjin e Katërt thuhej se ai “do të ketë kujdes maksimal për të mos shkelur trupat e qytetarëve tanë të dashur, kuajt e tyre ose karrocet dhe nuk do të marrë asnjë nga qytetarët tanë në duar, pa dëshirën e tyre” (Suift 30). Qindra rrobaqepës, kuzhinierë dhe kamerierë u vunë në punë për t’i qepur rrobat, përgatitur e shërbyer ushqimin. Duket sikur liliputët janë të gjindshëm, zemërgjerë dhe të sjellshëm, heronj të përsosur për një histori fëmijësh.

Megjithatë, po ta shohësh më me kujdes historinë, sharmi i liliputëve fillon të zbehet. Ndodhte që në zbatimin e ligjeve ata të ishin aq të papërgjegjshëm, saqë, edhe për shkak të mosmirënjohjes, të të dënonin me vdekje. (48). Nuk ishin të dashur me fëmijët, pasi vetëm dy herë në vit i lejonin që të takoheshin me prindërit e tyre. (50).

Suift, i cili kishte lindur në Irlandë (ishullin fqinjë të Anglisë), kur portretizonte liliputët, vinte në lojë mbretin, gjykatat dhe shoqërinë angleze. Në “Udhëtimet e Guliverit” ai satirizon edhe aspekte të tjera të shoqërisë njerëzore, si dhe dobësitë e saj.

Duket qartë që mendimet e Suiftit për njerëzit ishin të hidhura dhe të pafavorshme. Megjithatë ai i përshkroi marrëzitë dhe mizoritë tona në një mënyrë kaq krijuese, saqë “Udhëtimet e Guliverit” do të vazhdojë të magjepsë lexuesit e të gjitha moshave.

**Veprat e cituara**

Fairley, Matthew. *Xhonatan Suift. New York: Gemstone, 1986.*

Helmswood, Fern. “Veprat satirike të Xhonatan Suiftit”. “Të kuptojmë letërsinë”, 17 janar 1995: 31-34.

Rialto, Bettina. “Ata besuan te Guliveri”. “Fakte dhe trillime”, 6 korrik 1996: 43+.

Suift, Xhonatan. “Udhëtimet e Guliverit”. New York: Washington, 1969.

Për pyetjet nga 1 deri në 8 rrethoni alternativën e saktë.

1. Në këtë raport, cilës pyetje tenton t'i përgjigjet autori? **1 pikë**
- A) A shpenzoi Xhonatan Suifti pjesën më të madhe të jetës së tij duke udhëtuar?  
 B) Cilat ishin qëllimet e Suiftit kur shkroi *Udhëtimet e Guliverit*?  
 C) Si mundet një autor t'i bëjë njerëzit të besojnë se trillimet letrare janë të vërteta?  
 D) A ishte Guliveri një udhëtar i vërtetë apo një personazh i trilluar artistik?
2. Në paragrafin e tretë fjala **hiperbolë** do të thotë: **1 pikë**
- A) kritikë;  
 B) ekzagjerim;  
 C) pavarësi;  
 D) përparim.
3. Cila nga alternativat e mëposhtme mund të përdoret si një titull për paragrafin e dytë dhe të tretë të kësaj pjese? **1 pikë**
- A) Pranohen si ngjarje të vërteta "Udhëtimet e Guliverit".  
 B) Si t'i lexojmë "Udhëtimet e Guliverit".  
 C) "Udhëtimet e Guliverit": një histori magjepse për fëmijë.  
 D) Autori i famshëm i Udhëtimeve të Guliverit.
4. Cili informacion nga kjo pjesë mbështet idenë se "Udhëtimet e Guliverit" është një histori zbavitëse për fëmijë, pavarësisht qëllimit satirik të autorit të saj? **1 pikë**
- A) Shumë lexues e dënuan autorin për mosrespektim serioz të fakteve.  
 B) Kur u mor në konsideratë romani origjinal dhe i pashkurtuar, u pa qartë se vepra vinte në lojë marrëzinë njerëzore.  
 C) Me një vëzhgim të kujdesshëm, joshja e personazheve zvogëlohet.  
 D) Ngjarjet dhe personazhet në libër krijojnë përrallën imagjinare, plot ngjyra të një aventure.
5. Autori përfshin një informacion të mjaftueshëm për të treguar se: **1 pikë**
- A) Xhonatan Suiftit i pëlqen të shkruajë sidomos për fëmijët.  
 B) lexuesit e dinë tashmë se "Udhëtimet e Guliverit" është një trillim i pastër artistik.  
 C) Xhonatan Suifti kaloi kohën më të madhe të jetës së tij në Irlandë.  
 D) pasi kanë lexuar "Udhëtimet e Guliverit" njerëzit janë nxitur të udhëtojnë më shumë.
6. Cila nga alternativat e mëposhtme e ndihmon më shumë lexuesin të vlerësojë saktësinë e informacionit të dhënë në këtë pjesë? **1 pikë**
- A) Leximi i një biografie për Xhonatan Suiftin.  
 B) Shkrimi i një vepre satirike origjinale.  
 C) Rileximi i dokumenteve disa herë.  
 D) Kontrolli i burimit të faqeve të cituara.

7. Artikujt e ngjashëm me ato të cituara në këtë studim ka shumë të ngjarë të gjenden në këto revista:

**1 pikë**

- A) *Letërsia dhe Historia;*
- B) *Çështje politike aktuale;*
- C) *Udhëtime ndërkombëtare;*
- D) *Shkrime për fëmijë.*

8. Nëse autori i këtij shkrimi do të dëshironte të mësonte rreth veprave të tjera satirike të Xhonatan Suiftit, ai duhet të lexonte burimin e cituar të shkruar nga:

**1 pikë**

- A) Bettina Rialto;
- B) Xhonatan Suift;
- C) Fern Helmswood;
- D) Ted Danson.

9.

a) Rendisni dy argumente të këtij teksti që kanë bindur një pjesë lexuesish se historitë e romanit “Udhëtimet e Guliverit” ishin të vërteta.

**2 pikë**

---

---

b) Cili nga argumentet e përzgjedhura më sipër ju duket më bindës dhe pse?

**1 pikë**

---

---

10. Përgjatë shkrimit shpesh hasim disa fjalë ose fjali, të cilat autori i ka futur midis thonjzave. Për ç’qëllim ai e bën këtë?

**1 pikë**

---



**PJESA II****Migjeni*****Nën flamujt e melankolisë***

Në vendin tonë  
kudo valojnë  
flamujt e një melankolie  
të trishtueshme...  
...dhe askush s'mund të thotë  
se këtu rron  
një popull që ndërton  
diçka të re.  
Aty këtu në hijet  
e flamujve  
mund të shifet  
një mund, një përpjekje  
e madhe përmbi vdekje,  
për të pjellë diçka të madhe,

për të qitë në dritë një xhind!  
Por, (o ironi)  
nga ajo përpjekje lind  
vetëm një mi.  
Dhe kështu kjo komedi  
na plas dellin e gazit,  
nsa prej marazit  
pëlcasim.  
Në prakun e çdo banese  
ku ka ndoj shenj jetese  
valon nga një flamur  
melankolie të trishtueshme.

*Për pyetjet nga 12 deri në 15 rrethoni alternativën e saktë.*

- 12.** Poezia i takon llojit të lirikës: **1 pikë**
- A) intime;  
B) filozofike;  
C) shoqërore;  
D) patriotike.
- 13.** Kjo poezi mbizotërohet nga nota: **1 pikë**
- A) dhimbjeje;  
B) tragjike;  
C) satirike;  
D) optimiste.
- 14.** Në cilën prej alternativave të mëposhtme metafora është e shprehur me emër? **1 pikë**
- A) melankoli e trishtueshme;  
B) flamujt e melankolisë;  
C) për të pjellë diçka të madhe;  
D) kudo valojnë flamujt.
- 15.** Në këtë poezi *kotësia e jetës* shfaqet: **1 pikë**
- A) në të qeshurën prej marazit;  
B) në përpjekjet për të lindur një xhind;  
C) në popullin që ndërton diçka të re;  
D) në banesat ku ka shenja jete.
- 16.**
- a) Cila është atmosfera që krijohet në këtë poezi dhe çfarë e ka shkaktuar atë? **2 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- b) Çfarë simbolizon flamuri në këtë poezi? Si ndryshon kjo simbolikë nga ajo tradicionale?  
Pse Migjeni e ka sjellë nën këtë këndvështrim? **3 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

17. Identifikoni në fragment një rast të përdorimit të ironisë dhe shpjegojeni atë.

2 pikë

---



---

18. Analizoni pse poeti po përjeton një dramë të madhe. Mendimin tuaj ilustrojeni me vargje ose detaje nga poezia.

2 pikë

---



---



---

19. Zbuloni vargjet ku trishtimi i përgjithshëm merr ngjyrim personal. Si jepet ky kalim nga pikëpamja gjuhësore?

2 pikë

---



---

### PJESA III

#### Markez

#### *Njëqind vjet vetmi (fragment)*

Ishte një periudhë fejese disi e mugët, sepse italiani vinte gjithmonë kur binte mugëtira dhe gjithmonë kishte një gardenie në thilenë e xhakëtës. Në verandën e tejngopur me aromë manxurane dhe trëndafilash, ai përkhente sonetet e Petrarkës, teksa ajo thurte dantella, derisa mushkonjat i detyronin të kërkonin strehim në dhomën e ndenjies. Ndjeshmëria e Amarantës, sharmi i saj i përmbajtur e, megjithatë magjepsës, kishin endur përreth të fejuarve një si pëlhurë të padukshme merimange, të cilën ai me shumë mundim detyrohej ta hapërdante, ndaj dhe nuk dilte dot nga shtëpia e saj më parë se ora tetë e mbrëmjes. Me kartolinat që i vinin Pietro Krespit nga Italia ata bënë një album shumë të bukur: ishin pamje çiftesh të dashuruar ndër parqe të vetmuar, të stolisura me vizatime zemrash të shpuara me shigjetë e me fjongo të arta që i mbanin pëllumbat në sqep.

Të gjitha shenjzat tregonin se Amaranta po ecte drejt një lumturie pa shqetësime e tallaze. Vetëm se ajo, krejt ndryshe nga Rebeka, nuk po rrëfente kurrfarë padurimi. Po me atë durim, me të cilin i qëndiste me ngjyra të larmishme sofrabezet, i punonte me grep dantellat dhe sajonte me punim kryqi pallonj dhe lloj - lloj shpendësh, priste dhe çastin kur Pietro Krespi të mos mundte më ta përballonte dufin e zemrës. Dhe kur çasti erdhi së bashku me shirat e tetorit, Pietro Krespi ia hoqi gjergjefin nga prehri dhe ia mori dorën mes duarve të tij.

- Tani nuk po më pritet dot më!- i tha. – Muajin tjetër do të martohem!

Amaranta nuk është se u drodh nga ajo prekje e duarve të tij të ftohta. E tërhoqi dorën nga të tija si ndonjë kafshëz që merr arratinë dhe iu rikthye sërishmi punëdores.

- Lëri marrëzitë, Krespi,- i tha dhe fytyra iu shtrembërua nga një buzagaz i kithët. - Unë as e vdekur nuk do të martohesha me ty.

Pietro Krespi e humbi toruan. Nisi të qante me ngashërim dhe sa s'i theu gishtërinjtë e dorës nga dëshpërimi.

- Mos e humb kot kohën. Në qoftë se vërtetë më do, bën mirë mos të shkelësh më kurrë në këtë shtëpi! – Kjo ishte e gjitha ç'i tha Amaranta, për të mos iu kthyer më këtij muhabeti.

E la pas dore punën, e ngryste ditën në zyrën e vogël në anën e pasme të dyqanit, duke shkruar letra dashurie, që ia dërgonte Amarantës, duke i futur në zarfa o petale lulesh, o flutura të thara; por ajo ia kthente ato letra pa i hapur fare. Më pas ai mbyllej me orë të tëra dhe i binte kitarës. Një natë prej netësh ia mori dhe këngës. E gjithë Makondoja u zgjua si e magjepsur, a thua të ndodhej në qiellin e shtatë: dëgjonin të përgjëruar tingujt e kitarës, që nuk dukeshin se ishin të kësaj bote; dëgjonin zërin e prushtë të një mashkulli, që kurrë ndonjëherë s'e kishin dëgjuar më parë. Në të gjitha shtëpitë e fshatit Pietro Krespi pa drita të ndezura, po nuk pa të ndizej ndonjë dritë në dritaret e Amarantës. Më dy nëntor, të Dielën e të Vdekurve, vëllai i tij hapi dyqanin dhe i gjeti të gjithë shandanët ndezur, të gjitha kutitë muzikore të kurdisura, të gjitha orët të ndaluara në një pasmesnate dhe, në mes të atij ndriçimi dhe kumbimi tingujsh të ngatërruar, e pa Pietro Krespin te tryeza e punës me damarë të prerë dhe me të dyja duart të kredhura në një legen të mbushur me alkool.

Varrimi qe madhështor. Amaranta nuk doli nga dhoma e gjumit. Në shtrat siç ishte dëgjoi vajin e Ursulës, hapat dhe pëshpërimat e njerëzve që vërshuan shtëpinë, dëgjoi dhe vajin e vajtocave. Pastaj nuk dëgjoi më asgjë, ngaqë pllakosi një heshtje e thellë dhe u ndie kundërmimi i luleve të shkelura. Edhe për mjaft kohë, sapo binte mugëtira, Amarantës i bëhej sikur ndiente livandon e Pietro Krespit, por gjente në vete forcë sa të mos përhumbej në atë kujtim të mynxyrshëm. Ursula asaj i hoqi vizë. Ajo as që i ngriti sytë dhe nuk shprehu kurrfarë keqardhje atë ditë, kur Amaranta hyri në kuzhinë dhe vuri dorën në prushin e vatrës dhe e mbajti sa i dhëmbi aq fort, saqë nuk ndjeu më kurrfarë dhimbje, por vetëm erën e mishit të saj të përzhitur. Ishte një kurë e tmerrshme për t'u shëruar nga brejtjet e

padurueshme të ndërgjegjes. Disa ditë e panë të endej nëpër shtëpi me dorën të futur në një enë me të bardhë veze dhe, kur më në fund iu shëruan plagët e djegies, u duk sikur e bardha e vezës ia kishte mbyllur çibanët e zemrës. E vetmja gjurmë e jashtme, që i kishte lënë pas tragjedia, ishte fasha prej garze të zezë, me të cilën e pati mbështjellë dorën e djegur dhe që do ta mbante deri në vdekje.

20. Cili është nënteksti simbolik i detajit: *kundërmimi i luleve të shkelura*?

1 pikë

- A) Shpërfillja e njerëzve.
- B) Shenjtërimi i Krespit pas vdekjes.
- C) Shpirti i Krespit që s'gjen qetësi.
- D) Kujtimi i dashurisë së vdekur.

21. Prishja e lidhjes midis Amarantës me Pietro Krespin paralajmërohet me fjalët: “*Vetëm se nuk po tregonte kurrfarë padurimi*”. Shpjegoni pse mungesa e *padurimit* është shenja e parë e asaj që do të ndodhë më pas.

2 pikë

---



---

22.

a) Ku qëndron ndryshimi më i madh midis Amarantës dhe Pietro Krespit?

1 pikë

---



---

b) A ka diçka të tepruar në mënyrën se si e shpreh Pietro Krespi dashurinë dhe vuajtjen? Argumentoni mendimin tuaj duke e ilustruar me shembuj nga fragmenti.

3 pikë

---



---



---

23.

a) A mendoni se Amaranta është shkaktare e vetëvrasjes së Pietro Krespit? Mbështeteni mendimin tuaj edhe me ilustrime nga fragmenti.

2 pikë

---



---

b) Pse Amaranta e djeg dorën pas vdekjes së Krespit? Ç'kuptim simbolik merr fasha e zezë në dorën e saj deri në fund të jetës?

2 pikë

---



---

c) Shpjegoni forcën shprehëse që merr fjala *të mynxyrshëm* në fjalinë: “*Gjente në vete forcë sa të mos përhumbej në atë kujtim të mynxyrshëm*”.

1 pikë

---



---

24. Lexoni me vëmendje fjalinë: “*E gjithë Makondoja u zgjua dhe dëgjonte si e magjepsur zërin e prushtë të mashkullit që s'e kishin dëgjuar kurrë*”. Cila karakteristikë e banorëve të këtij vendi shfaqet në këtë fragment?

1 pikë

---



---

25. Një nga tiparet e rrëfimit të Markesit është parimi i befasisë dhe i përmbysjes së situatës. Gjeni në tekst një moment të tillë dhe shpjegoni pse e përdor shkrimtari këtë mënyrë rrëfimi.

2 pikë

---



---